



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0240

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) EUROPRINT GROUP SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE TË KOSOVËS në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Shërbime të dizajnit, shtypjes, fotokopjimit, skanimit dhe libërzimit të materialeve për aktivitete të ASHAK-ut” me numër të prokurimit 231-25-1802-2-3-6, me 14.05.2025, mori:

Vendim

1. **Aprovohet**, si e bazuar ankesa e OE EUROPRINT GROUP SH.P.K. me nr. 2025/0240, e datës 05.04.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Shërbime të dizajnit, shtypjes, fotokopjimit, skanimit dhe libërzimit të materialeve për aktivitete të ASHAK-ut” me numër të prokurimit 231-25-1802-2-3-6.

2. **Anulohet** B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK të AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE TË KOSOVËS, ndërkaq aktiviteti i prokurimit “Shërbime të dizajnit, shtypjes, fotokopjimit, skanimit dhe libërzimit të materialeve për aktivitete të ASHAK-ut” me numër të prokurimit 231-25-1802-2-3-6 kthehet në **Rivlerësim**.

3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

4. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik EUROPRINT GROUP SH.P.K.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 12.03.2025 AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE TË KOSOVËS., duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin për kontratë, për aktivitetin e prokurimit “Shërbime të dizajnit, shtypjes, fotokopjimit, skanimit dhe libërimit të materialeve për aktivitete të ASHAK-ut” me numër të prokurimit 231-25-1802-2-3-6.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 6,000.00 Euro.

Me 28.03.2025, AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, me të cilin ka shpërblyer me kontratë OE EURO.

Me 28.03.2025, OE EUROPRINT GROUP SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim, e cila është refuzuar si e pa bazuar me Vendimin e AK të datës 01.04.2025.

Me 05.04.2025, OE EUROPRINT GROUP SH.P.K., ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokolli 2025/0240, duke e atakuar Vendimin e cituar si më sipër të AK.

Me 06.05.2025, është autorizuar/caktuar Paneli Shqyrtues për shqyrtimin e kësaj lënde.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e Operatorit Ekonomik EUROPRINT GROUP SH.P.K., lidhur me ankesën 0240/2025:

Me datën 28.03.2025 kemi kërkuar qasje në dokumentet e Operatorit Ekonomik të rekomanduar për kontratë, dhe gjatë analizimit të çmimeve kemi vërejtur se ka çmime jonormalisht të ulëta. Kjo bazohet edhe në dallimin e dukshëm të ofertave ndërmjet operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë aktivitet.

Autoriteti Kontraktues/Zyra e Prokurimit është dashur të veprojë konform nenit 41 "Tenderët jonormalisht të ulët" dhe të trajtojë ofertën e operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë si e tillë. Ne kemi kërkuar nga Autoriteti Kontraktues që të veprojë në përputhje me nenin 61 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) dhe nenin 41 të Rregullores nr. 002/2024, si dhe konform Udhëzuesit nr. 002/2024 për plotësim dhe ndryshim të Udhëzuesit nr. 001/2023 për Prokurim Publik. Por kërkesa jonë është refuzuar me arsyetimin se kjo procedurë nuk është kontratë kornizë, por kuotim çmimi — kur dihet mirëfilli se Ligji për Prokurimin Publik zbatohet për të gjitha procedurat e prokurimit.

Sipas Udhëzuesit nr. 002/2024 për plotësim dhe ndryshim të Udhëzuesit nr. 001/2023 për Prokurim Publik — Pika 11: Tenderët Jonormalisht të Ulët, thuhet:

11.1 Në çdo rast kur tenderët duken jonormalisht të ulët, Autoriteti Kontraktues do të veprojë në përputhje me nenin 61 të LPP-së dhe nenin 41 të Rregullores për Prokurimin Publik.

Gjatë kësaj procedure janë pranuar gjithsej katër (4) oferta si në vijim:

EUROPRINT GROUP SHPK – 5,584.00 EUR

TROTEK SHPK – 5,749.00 EUR

D.P. RICOH 1 – 8,909.50 EUR

RIKON SHPK – 2,926.50 EUR

Analiza e çmimeve:

Totali i ofertave: 23,169.00 EUR

Mesatarja: 5,792.25 EUR

Vlerësimi sipas tre kushteve për ofertë jonormalisht të ulët:

Kushti 1: Janë pranuar më shumë se tri oferta – PLOTËSOHET

Kushti 2: Çmimi i ofertës së rekomanduar (2,926.50 EUR) është më shumë se 30% më i ulët se mesatarja – PLOTËSOHET

Pragu 30%: $5,792.25 / 1.3 = 4,455.57$ EUR

Kushti 3: Ofertës së rekomanduar i mungon 10% krahasuar me ofertën e dytë më të lirë (EUROPRINT) – PLOTËSOHET

Pragu 10%: $5,584.00 / 1.1 = 5,076.36$ EUR

Bazuar në këtë analizë dhe në përputhje me ligjet dhe udhëzuesit në fuqi, kërkojmë që oferta e rekomanduar për kontratë e RIKON SHPK të konsiderohet si ofertë jonormalisht e ulët dhe të eliminohet nga aktiviteti i prokurimit.

Gjithashtu, nëse është e nevojshme, jemi të gatshëm të bashkëngjisim edhe disa vendime të mëparshme të OSHP-së, ku në raste të ngjashme ofertat jonormalisht të ulëta janë eliminuar, ndërsa ofertat tona janë vlerësuar të rregullta.

Kërkojmë nga OSHP, eksperti dhe paneli përkatës që, në përputhje me dispozitat ligjore të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Nr. 05/L-068 dhe Nr. 05/L-092, të aprovojë ankesën tonë si të bazuar dhe të eliminojë ofertën e operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë si jonormalisht të ulët.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim:

Përgjigje nga AK për pretendimin 1:

Pretendimi OE EUROPRINT GROUP SH.P.K., se OE i rekomanduar për kontratë ka dhënë çmime jo normalisht të ulëta, në disa artikuj që janë të lirë me çmime të tregut oe i rekomanduar

ka vendosur çmime të larta dhe e kundërta, ky pretendim është komplet i pa bazuar dhe ndër të tjera edhe për faktin se kjo procedure nuk është kontratë kornizë, por është kuotim i çmimit, ku kontraktuesi do ti dorëzoj të gjitha mallrat me çmimin e ofertuar.

Prandaj AK-ASHAK e konsideron sit ë pa bazuar këtë pretendim.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 08.04.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2025/0240, ndërsa me datë 18.04.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2025/0240, me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është pajtuar rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues ndërsa OE nuk është përgjigjur lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtresat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OEEUROPRINT GROUP SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0240, ka vlerësuar si në vijim:

Sqarim hyrës: Autoriteti Kontraktues (AK) – AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE TË KOSOVËS. gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar:

Procedurë të hapur,

Lloji i kontratës Shërbime .

Vlera e parashikuar e kontratës 6.000,00 €.

Kriteret e Dhënies së kontratës Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët.

OE ankues ka parashtruar ankesë pranë OSHP-së Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër vendimit të AK, Me datën: 05.04.2025, OE “EUROPRINT GROUP SH.P.K.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr.: 2025/0240, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE “RIKO SHPK lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Shërbime të dizajnit, shtypjes, fotokopjimit, skanimit dhe liberzimit të materialeve për aktivitete të ASHAK-ut”, me nr. të prokurimit: "231-25-1802-2-3-6", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE TË KOSOVËS.,

Pretendimi 1

Me datën 28.03.2025 kemi kërkuar qasje ne dokumentet e OE te rekomanduar për kontrate dhe gjate analizimit te çmimeve kemi vërejtur se ka çmime jo normalisht te ulëta , kjo bazohet edhe ne diferencën e ofertës ne mes se OE pjesëmarrës ne këtë aktivitet. - AK/Zyra e prokurimit është dashur qe te veproj kondromë Nenit 41 Tenderët Jo-normalisht të Ulët dhe ta trajtoj oferten e OE te rekomanduar per kontrate si Tenderët Jonormalisht të Ulët

Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues..

Pretendimi 1 Eksperti shqyrtues thekson se sipas nenit 59. Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve është përgjegjësi dhe kompetencë e Autoritetit Kontraktues dhe ne përputhje me paragrafin 4 te nenit 59 4. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit!

Eksperti Shqyrtues , Konstaton që Autoriteti Kontraktues (AK) – AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE TË KOSOVËS – dhe Komisioni Vlerësues, bazuar në Ligjin Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, I ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, përkatësisht në:

Neni 61

Tenderët Jo-Normalisht të Ulët

1. Nëse një operator ekonomik e dorëzon një tender që, është ose duket të jetë jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të dërgojë një kërkesë me shkrim tenderuesit ku kërkohet nga tenderuesi që të dorëzojë me shkrim : (i) një ndarje të elementeve përbërëse të tenderit dhe (ii)

Dhe sipas Rregullores për Prokurim Publik kur një tender plotëson kushtet Neni 41 Tenderët Jo-normalisht të Ulët

41.3 Autoritetet kontraktuese do të kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar për tenderët e përgjegjshëm, kur të përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme:

- i. çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm;
- ii. çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët;
- iii. janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë.

Ne rastin konkret Eksperti Shqyrtues , Konstaton që Autoriteti Kontraktues pasi ka pranuar tre ofertat e përgjegjshme si ne vijim:

- 1.OFERTA 1 – 5,584.00 EURO
- 2. OFERTA 2 – 5,749.00 EURO
- 3. OFERTA 3 – 8,909.50 EURO
- 4. OFERTA 4– 2,926.50 EURO

Nga ofertat e pranuar dhe bazuar Neni 61 Tenderët Jo-Normalisht të Ulët dhe sipas Rregullores për Prokurim Publik kur një tender plotëson kushtet Neni 41 Tenderët Jo-normalisht të Ulët, pasi është konstatuar që oferta i plotëson të tre kushtet, është dashur të bëjë Kërkesë të Operatori Ekonomik i ofertës me të lire, dhe të kërkojë sqarime me shkrim mbi Ofertën,

sepse sipas nenit 41.3 të kësaj rregullore, AK duhet të kërkojë një deklaratë me shkrim nga O.E, e cila përfshinë një zbatim të detajuar të pjesëve relevante të tenderit dhe e cila përfshinë një shpjegim për çmimin e ultë duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP-ja "Shkresa standarde për tenderët jonormalisht të ulët".

Dhe nese,

41.7 Operatori Ekonomik do të përgjigjet me shkrim Autoritetit Kontraktues. Nëse jo, tenderi do të refuzohet.

Dhe nëse sipas Rregullores për Prokurim Publik neni

41.10 Pasi që Autoriteti kontraktues merr shpjegimin me shkrim nga Operatori Ekonomik, Autoriteti

Kontraktues duhet ose:

a. Nëse sqarimi është i mjaftueshëm, të trajtoj tenderin njëjtë me tenderët tjerë; ose

b. Nëse sqarimi nuk mjafton, të refuzoj tenderin

Prandaj AK, pasi nuk ka kërkuar Deklaratë me shkrim sipas Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, nenit 41.3 përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP-ja "Shkresa standarde për tenderët jonormalisht të ulët", bie në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe ANKESA e OE është e bazuar.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet Pjesërisht e Bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik konkretisht nenin 61 të LPP. lidhur me aktivitetin e prokurimit "Shërbime të dizajnit, shtypjes, fotokopjimit, skanimit dhe libërimit të materialeve për aktivitete të ASHAK-ut" me numër të prokurimit 231-25-1802-2-3-6.

Paneli Shqyrtues, administroi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë aktet dhe veprimet e AK, parashtresat dhe provat e ankuesit dhe raportin e ekspertit shqyrtues dhe duke i analizuar të gjitha ato në kontekstin e përgjithshëm të kësaj çështje ka krijuar bindjen e pavarur e tij/sajë, se ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar. Në këtë rast Paneli shpjegon se raporti i ekspertizës është hartuar në mënyrë profesionale dhe i njëjti i përmban të gjitha pohimet ankimore dhe analizat lidhur me to, duke i shpjeguar në mënyrë specifike në raport me dispozitat e shkelura, sikurse kërkohet kjo së paku me dispozitën e nenit 113 dhe 114 të LPP-së. Si rrjedhojë, Paneli Shqyrtues

e mbështet rekomandimin e ekspertit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në ri-vlerësim dhe AK të veproj konform rekomandimeve të ekspertit shqyrtues të paraqitura në raportin e ekspertizës..

Paneli vlerësues sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: “Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” si dhe në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP-së, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Paneli Shqyrtues, pas shqyrtim të gjitha fakteve dhe argumenteve ka ardhur në përfundim se AK gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit nuk ka respektuar dispozitat ligjore të LPP-së, kështu që urdhëron AK-në që gjatë rivlerësimit të këtij aktiviteti të prokurimit të ju përmbahet në tërësi dispozitave ligjore të LPP-së.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE TË KOSOVËS**
- **OE - EUROPRINT GROUP SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: